



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

KUVENDI

NR. 3020 DATE 23.11.21

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**Lënda:** Propozohet për shqyrtim dhe miratim një amendament në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”.

**Drejtuar:** **Znj. Lindita NIKOLLA**  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë.

**Këtu**

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Neni 75, pika 4 e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë parashikon se: “Cdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë përpara fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë.”

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim amendamentin në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”, shoqëruar me relacionin përkatës, të paraqitur nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Z. Bujar Leskaj dhe Z. Alfred Rushaj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARI**

**Alfred RUSHAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT  
2022”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetët Z. Bujar Leskaj dhe Z. Alfred Rushaj propozojnë,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2022” bashkëlidhur, në emërimin “Totali i Shpenzimeve”, zëri 7 “Shpenzime të tjera” - “Kompensim për ish të përndjekurit politikë”, në kolonën “Buxheti 2022”, vlera “1,000” të zëvendësohet me vlerën “10,000”.

**Neni 2**

Në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2022” bashkëlidhur, në emërimin “Totali i Shpenzimeve”, zëri 3 “Shpenzime Operative Mirëmbajtje, nga të cilat “të qeverisjes qendrore”, në kolonën “Buxheti 2022”, vlera “57,268” të zëvendësohet me vlerën “51,268”.

**Neni 3**

Në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2022” bashkëlidhur, në emërimin “Totali i Shpenzimeve”, zëri 3 “Shpenzime Kapitale – financim i brendshëm”, në kolonën “Buxheti 2022”, vlera “61,791” të zëvendësohet me vlerën “58,791”.

## **Neni 4**

Të gjitha këto shtesa dhe pakësime të pasqyrohen edhe në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

## **RELACION**

### **PËR AMENDAMENTIN**

#### **PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

##### **I. QËLLIMI I AMENDAMENTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Amendamenti synon që nëpërmjet 10-fishimit të fondeve të akorduara nga qeveria shqiptare për dëmshpërblimin e të ish-përndjekurve politikë t’u japë mundësi këtyre personave, por edhe familjarëve të tyre, që të përfitojnë në një kohë sa më të shkurtër shpërblimet që iu takojnë. Kjo jo vetëm si një detyrim i qartë ligjor, por edhe në funksion të drejtësisë dhe paqes sociale.

Nga ana tjetër, nëpërmjet një politike që synon rritjen e financimit buxhetor me do të bëhet e mundur që brenda 3 viteve të ardhshme qeveria shqiptare të përmbyllë plotësisht detyrimet e saj financiare ndaj përfituesve të kësaj shtrese, të cilët prej tetë vitesh përballen me zvarritje dhe premtime të mbajtura nga qeveria socialiste.

10-fishimi i fondeve për vitin 2022 dhe ruajtja e të njëjtës masë financimi për vitet 2023 dhe 2024 do të përmbyllte një herë e mirë historinë aspak të lavdishme të shtetit shqiptar, me shtresën më të vuajtur, më të persekutuar dhe më të diskriminuar në 45 vitet e regjimit diktatorial.

##### **II. ARGUMENTIMI I AMENDAMENTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Shumë propagandë, por pak financim. Kjo është e vërteta e hidhur e 8 viteve të fundit lidhur me dëmshpërblimin financiar ndaj shtresës së përvuajtur të ish-përndjekurve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre.

Financimi nga buxheti i shtetit gjatë 8 viteve të fundit ka qenë tejet larg pritshmërive dhe vetë premtimeve të qeverisë. Mjaftojmë të kujtojmë premtimet e bujshme të fushatës



elektorale 2013, ku Partia Socialiste zotohej se me marrjen e pushtetit do të kryente dëmshpërblimin e plotë financiar brenda viteve të para të qeverisjes së saj.

E gjithë propaganda rezultoi në një mashtrim të rradhës.

KLSH në raportin e saj të fundit për zbatimin e buxhetit të shtetit 2020, ka konstatuar se detyrimet financiare ende të papaguara të qeverisë ndaj kësaj shtrese arrijnë në vlerën mbi 31 miliardë lekë.

Fatura financiare totale e miratuar me aktet ligjore dhe nënligjore, arrin në vlerën pothuajse 52 miliardë lekë, ndërkohë që deri më sot (nga 2008 – vazhdim), nga buxheti i shtetit janë paguar vetëm 21 miliardë lekë, pra vetëm 40% e detyrimit total financiar.

Duke marrë në konsideratë faktin që qeveria planifikon në buxhetin e vitit 2022 dhe PBA për vitet e ardhshme një fond vjetor prej vetëm 1 miliardë lekë, arrijmë lehtësisht në konkluzionin se me këtë ritëm financimi do të duhen plot tre dekada për të përmbyllur detyrimin financiar ndaj shtresës së ish të përndjekurve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre.

Nevojitet të theksojmë, se qëllimi i këtij dëmshpërblimi është t'i arrijë grupit të kategorisë parësore si dhe grupit të kategorisë jo parësore. Një vlerë e tillë e akomoduar prej qeverisë në projektbuxhetin 2022 dhe PBA nuk e përmbush qëllimin e dëmshpërblimit por vetëm e shtyn atë në kohë, duke humbur me kalimin e kohës qëllimin e dëmshpërblimit por edhe duke ulur vlerën reale të parasë që duhet të përfitojnë.

Për këtë arsye, lind nevoja e rishikimit në rritje të financimit buxhetor vjetor. Nisur nga përgjegjshmëria politike dhe morale e gërshetuar edhe me mundësitë financiare të buxhetit të shtetit, propozojmë 10-fishimin e vlerës së propozuar nga qeveria për dëmshpërblimin e shtresës së ish të përndjekurve për vitin 2022, nga 1 miliardë lekë që propozohet nga qeveria në projektbuxhet, në 10 miliardë lekë.

Është tregues i përgjegjshmërisë politike dhe morale që paratë e buxhetit të shtetit të shkojnë të qytetarët dhe shtresat e përvojshme dhe në nevojë, dhe jo për shpenzime luksi të fshehura nën “petkun” e shpenzimeve operative dhe rikonstruksione dhe mobilime zyresh qeveritare. Gjithashtu, edhe në vitet e ardhshme 2023 – vazhdim, financimi buxhetor duhet të ruajë të njëjtën masë me vlerën e propozuar në këtë amendament me

qëllim përmbylljen përfundimisht të detyrimeve financiare ndaj kësaj shtrese brenda tre viteve të ardhshme.

### III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Amendamenti është propozim i dy deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit.

### IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË AMENDAMENTIT

Amendamenti përbëhet nga tre dispozita:

- (i) **Neni 1** sjell një ndryshim në Tabelën 4 “Treguesit fiskal t-2 deri t+2) 2022”, në zërin 7 “Shpenzime të tjera” – “Kompensim për ish të përndjekurit politikë”, kolona “Buxheti 2022”, ku vlera “1,000” zëvendësohet me vlerën “10,000”;
- (ii) **Neni 2** sjell një ndryshim në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2022”, në zërin 3 “Shpenzime Operative Mirëmbajtje”, nga të cilat “të qeverisjes qendrore”, kolona “Buxheti 2022”, vlera “57,268” zëvendësohet me vlerën “51,268”;
- (iii) **Neni 3** sjell një ndryshim në Tabelën 4 “Treguesit fiskal (t-2 deri t+2) 2022” bashkëlidhur, në emërimin “Totali i Shpenzimeve”, zëri 3 “Shpenzime Kapitale – financim i brendshëm”, në kolonën “Buxheti 2022”, vlera “61,791” të zëvendësohet me vlerën “58,791”;
- (iv) **Neni 4** parashikon që dy ndryshimet e mësipërme të reflektohen në tekstin integral të projektligjit, tabelat dhe anekset bashkëlidhur tij.

### V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË EFEKTEVE BUXHETORE

Shtesa prej 9 miliardë lekë në fondin e dëmshpërblimeve për ish-përndjekurit politikë, nuk çënon qëndrueshmërinë e financave publike dhe treguesve të saj fiskalë, pasi propozojmë që të ulen me 6 miliardë lekë shpenzimet operative të qeverisjes qendrore (të cilat rriten nga qeveria me 8.7 miliardë lekë krahasuar me Buxhetin e Vitit 2021), dhe 3 miliardë lekë do të gjenden nga fondi total i shpenzimeve kapitale, të cilat ishin të destinuara për shpenzime luksi në kohë krizash (rikonstruksione zyrash dhe godinash qeveritare, mobilime dhe pajisje zyrash, blerje automjesh).

**Bujar LESKAJ**

6

**Alfred RUSHAJ**



Relativ me  
Seancave  
24/11/2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** RRRITJA E PAGAVE TË MESUESËVE NË TABELËN  
NR. 1 TË BUXHETIT NË KODIN 11/09120 DHE NË KODIN 11/09230.

**KËRKUES:**

Znj. Monika Kryemadhi

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:**

“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN  
PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

**BAZA LIGJORE:**

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Në vitet e fundit Shqipëria po kalon nga njëra krizë në tjetrën, ku mbi të gjitha kriza e besimit ndaj institucioneve dhe ajo financiare po detyrojnë qytetarët të largohen çdo ditë. Ky fenomen më së shumti ndjehet në shkollat dhe universitetet tona, ku numri i nxënësve dhe studentëve ulet në mënyrë të përvitshme. Shkolla të arsimit parauniversitar mbyllen çdo vit e njëkohësisht çdo vit mbyllen degë në universitete duke krijuar edhe mungesa të rëndësishme në tregun e punës. Sektori i arsimit është një ndër sektorët më të nënvlerësuar, pa investim dhe pa vizion serioz. Kur krahasohen buxhetet, pagat e programet e Shqipërisë me vende të tjera të rajonit, ne vazhdimisht jemi në vendin e fundit. Ndaj po paraqesim këto amendime që rrisin buxhetin e arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë, me synim kthimin e arsimit në prioritet kombëtar dhe investimin në burimet njerëzore që përbëjnë edhe shtyllën e shoqërisë shqiptare.

Rritja prej vetëm 6% e pagës së mësuesve të arsimit parauniversitar është e pamjaftueshme duke marrë në konsideratë rritjen e cmimeve në përgjithësi, ndaj në zërin shpenzime korente për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm shtohen gjithësej 2 miliard lekë, respektivisht 1,4 miliard për arsimin bazë dhe 600 milion lek për arsimin e mesëm, me qëllim rritjen e pagës së mësuesve dhe financimin e programeve të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvénit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”,* parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**MONIKA KRYEMADHI**



ERISHA KHIXHO





## **ANEKSI 1**

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2022 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në Nenin 1 të shtohet pika: "Për buxhetin e vitit 2022 të **RRITEN PAGAT E MESUESËVE NË TABELËN NR. 1 TË BUXHETIT NË KODIN 11/09120 DHE NË KODIN 11/09230.**

Shënimet  
Shkencore  
24/11/2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT: RITJJA E SHPENZIMEVE KORRENTE NË TABELËN NR 1, NË KODIN 11/09450 DHE NË KODIN 11/09770 ME QËLLIM RITJEN E GRANTEVE NË MËSIMDHËNIE DHE NË KËRKIME SHKENCORE.**

**KËRKUES:**

**Znj. Monika Kryemadhi**

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:**

**“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

**BAZA LIGJORE:**

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Pas protestave studentore të vitit 2018, asnjë ndryshim real buxhetor nuk është bërë për arsimin e lartë për të plotësuar kërkesat e shprehura nga vetë studentët. Arsimi i lartë dhe kërkimi shkencor vazhdojnë të jenë të nëninvestuar duke e bërë kështu të pamundur rritjen e cilësisë së universiteteve. Me qëllim rritjen e pagave të pedagogëve dhe përgjysmimin e tarifave studentore, amendimi propozon që në zërin shpenzime korente për Arsimin e Lartë të shtohen edhe 5 miliard lekë. Ky buxhet që shtohet i shkon grantit për mësimdhënie.


Me qëllim shtimin e projekteve të kërkimit shkencor, hapjen e doktoraturave dhe ngritjen e laboratorëve modern të kërkimit shkencor, propozohet që në zerin për kërkimin shkencor të shtohet vlera prej 5 miliard lekësh. Kërkimi shkencor nuk është i domosdoshëm vetëm për akademikët dhe studentët, por për të gjithë profesionet. Në ditët e sotme bazuar në rëndësinë e kërkimit , ai duhet të kthehet në një nga misionet kryesore të Universiteteve dhe qeverisë duke investuar dhe duke krijuar hapësira të nevojshme për kultivimin e një kërkimi shkencor të shëndetshëm.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvénit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqësë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”*, parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**MONIKA KRYEMADHI**



Eriša Xhixho  
Deputet



## **ANEKSI 1**

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2022 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në Nenin 1 të shtohet pika: “Për buxhetin e vitit 2022 të **RRITEN SHPENZIMET KORRENTE NE KODIN 11/09450 DHE NË KODIN 11/09770 ME QELLIM RRITJEN E GRANTEVE NË MËSIMDHËNIE DHE NË KËRKIME SHKENCORE** të Ministrisë së Arsimit.

Shënim  
Lejvare  
24/11/2021



KUVENDI  
NR 3036 DATE 24.11.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:** RITJA E BUXHETIT NË PROGRAMIN  
BUXHETOR” ZHVILLIMI RURAL” TË MINISTRISË SË BUJQËSISË

**KËRKUES:** Znj. Monika Kryemadhi  
Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:** “PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN  
PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

**BAZA LIGJORE:** Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Buxheti i vitit 2022 sa i takon ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kundërshtim me pritshmëritë dhe situatën aktuale ekonomike të bujqësisë shqiptare ka pësuar si rrallë herë një rënie prej 2%.

Me prezantimin e buxhetit nga ana e Kryeministrit dhe e Ministres së Bujqësisë, është deklaruar se mbështetja për programin buxhetor të “Zhvillimit rural” të Ministrisë së Bujqësisë, do të jetë 7.1 miliard lekë.

Ky deklaram nga ana e kryeministrit nuk është i vërtetë, dhe ka krijuar konfuzion në këtë sektor.

Pasi kam shqyrtuar buxhetin dhe tabelat përmbledhëse të cilat i bashkangjiten këtij buxheti, kam konstatuar që fondi për zhvillimin rural me qëllim mbështetjen direkte të fermerëve, në të vërtetë është vetëm 3.2 miliard lekë.

Kjo shumë korrespondon me zërin 606 "Transferta për buxhetet familjare dhe individët" në tabelën 5 shoqëruese të shpenzimeve sipas institucioneve.

Gjithashtu në prezantimin e buxhetit nga ana e Ministres së Bujqësisë në komisionin e veprimtarive prodhuese, në faqen 2 paragrafi i fundit, konfirmohet sa më sipër. Në të njëjtin procesverbal, në faqen 6, Ministria e Bujqësisë informon deputetët se nga shuma 3.2 miliard si mbështetje direkte e fermerëve, shuma prej 1.04 miliardë do të shkojnë për skemën e naftës falas për punimet e mekanizuara. Si rrjedhojë, mbështetja direkte e qeverisë shqiptare për skemat mbështetëse në sektorin e bujqësisë ngelet rreth 2.2 miliardë lekë ose afërsisht 18 milion euro.

Duke patur parasysh rëndësinë kombëtare të sektorit të bujqësisë si një nga kontribuesit kryesorë në ekonominë shqiptare me rreth 20% të GDP-së, konstatoj se mbështetja buxhetore prej 2.2 miliardesh është tërësisht e pamjaftueshme për këtë sektor. Duke patur parasysh dhe pasojat e pandemisë është në kushtet e mbijetesës.

Sa më sipër, duke patur parasysh dhe deklaratat e kryeministrit, i cili në të gjitha daljet e tij publike ka insistuar që mbështetja direkte për fermerët në programin buxhetor të "Zhvillimit rural" është 7.1 miliardë lekë, kërkoj që në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2022", të shtohet shuma prej 4,9 miliardë lekë.

Kjo shumë duhet t'i shtohet programit buxhetor me kod 04250 "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor blegtoral, agroindustrial dhe marketingun" në totalin e shpenzimeve korrente.

Gjithashtu kjo shumë prej 4.9 miliardë lekësh duhet të pasqyrohet në zërin 606 "Transferta për buxhet familjar dhe individët".

Kjo mbështetje e tillë buxhetore do të ndikonte pozitivisht në të gjithë sektorët e bujqësisë dhe blegtorisë shqiptare.



Duke qenë se dhe vetë kryeministri, në çdo takim publik si dhe deklarata zyrtare është shprehur se mbështetja direkte për fermerët do të ishte 7.1 miliardë lekë, atëherë shumës aktuale prej 2.2 miliardësh lekë , që është realisht mbështetja e parashikuar në këtë buxhet, në qoftë se do t'i shtohet dhe shuma e propozuar prej meje prej 4.9 miliard lekesh, atëherë do të ishte ekzaktësisht shifra e deklaruar nga vetë kryeministri.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvénit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”*, parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

**MONIKA KRYEMADHI**



Erisa Xhixho  


## **ANEKSI 1**

Në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2022", të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në nenin 1 ,të shtohet pika "Për buxhetin e vitit 2022 të shtohet shuma prej 4.9 miliardë lekë të. programit buxhetor me kod 04250 "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor blegtoral, agroindustrial dhe marketingun" në totalin e shpenzimeve korrente të Ministrisë së Bujqësisë.

Kjo shtesë pasqyrohet në të gjitha nenet dhe anekset e ligjit.

Shërbimi i  
Seancave  
24/11/2021

KUVENDI  
NR 3040 DATE 24.11.21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

**TITULLI I AMENDAMENTIT:**

RRITJA E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR  
RIMBURSIMIN E BARNAVE TË QYTETARËVE TË  
INFEKTUAR ME COVID-19.

**KËRKUES:**

Z. PETRIT VASILI

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**OBJEKTI:**

“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKT- LIGJIN -  
BUXHETIN E VITIT 2022”

**BAZA LIGJORE:**

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

**ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:**

Shqipëria vazhdon të përballet me pandeminë e COVID-19 dhe mijëra qytetarë për arsye ekonomike e kanë të pamundur të blejnë barna për trajtimin e sëmundjes, edhe aktualisht numri i përditshëm i rasteve të reja të të infektuarëve me COVID-19 vazhdon të jetë i lartë me një mesatare rreth 500 raste në ditë, që do të thotë mijëra raste të reja në çdo muaj.

Gjithashtu, kujtojmë se Europa po përballet më një valë të re serioze të përhapjes së COVID-it dhe shifrat flasin qartë se edhe Shqipëria po përballet me një shtim serioz të rasteve. Deri më tani, vetëm sipas shifrave zyrtare janë rreth 200.000 të infektuar, ndërkohë është e njohur publikisht që raste reale janë shumë herë më të larta se kaq.



Deri më tani, nga xhepat e Shqipëtareve kanë dalë mbi 180 milion euro për trajtime mjekësore që lidhen me COVID. Shteti dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë rimbursuar rreth 8000 qytetarë për një vlerë rreth 32 milion lekë ose afërsisht 320.000 dollarë.

Pikërisht për këtë arsye, kërkojmë një shtesë prej 2 miliard lekë si shtesë në Buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, me destinacion rimbursimin e barnave për të sëmurët e infektuar me COVID-19.

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”,* parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e shëndetësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

DEPUTETI:



(emër, mbiemër, nënshkrimi)



## **ANEKSI 1**

Në projektligjin "Për buxhetin e vitit 2022", të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

### **Neni 1**

Në nenin 1 , të shtohet pika "Te krijohet një shtesë në buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, prej 2 miliard lekë me destinacion rimbursimin e barnave për të sëmuret e infektuar me Covid-19".

Kjo shtesë pasqyrohet në të gjitha nenet dhe anekset e ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_/\_\_/2021

**Lënda:        Amendament për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”**


E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim në seancë plenare një amendament në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Në tabelën 1 të projektligjit, sipas referencës në nenin 11, të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

“Në grupin 63, “Institucionet e sistemit të drejtësisë”, “Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar” shtohen shpenzimet korrente me 60 milionë lekë.

**DEPUTETI**

  
**Taulant BALLA**



## RELACION

Mbështetja financiare e të gjitha institucioneve të reformës në drejtësi, përfshirë dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nëpërmjet të cilës synohet krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropian, ka qënë një ndër objektivat primarë të Projektbuxhetit për vitin 2022.

Megjithë mbështetjen e vazhdueshme buxhetore, në kuadër të përshejtimit dhe racionalizimit të procesit të vetingut por edhe të vazhdimit më ritme të shpejta të gjykimeve të çështjeve të juridiksionit disiplinor gjithnjë e në rritje të KPA-së, është e rëndësishme alokimi i të gjitha burimeve financiare të nevojshme në zërin e pagave dhe shpenzimeve dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të këtij institucioni. Mbështetur në këtë argument e mësipërm propoj shtesën e zërit të shpenzimeve korrente për Kolegjin e Posaçëm të Apelit me 60 milion lekë.

Alokimi i të gjithave burimeve financiare të nevojshme për këto zëra do të ndikojë drejtëpërsëdrejti në avancimin me ritme sa më të shpejta të punës së KPA-së dhe përmbylljen e procesit brenda mandatit që parashikon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.